



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2575, datë 01.06.2015

Për

**Miratimin e disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.22 datë 24.06.2011 “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” dhe përfundimin e këshillimit publik të realizuar për këtë dokument.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 01.06.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP miratuar me Vendimin nr. 2506 datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, pasi shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.22 datë 24.06.2011 “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” dhe përfundimin e këshillimit publik të realizuar për këtë dokument.**

**BAZA LIGJORE:**

- 1) Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative” i ndryshuar.
- 2) Nenet 7, 8, 20, 21, 96, 114, 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**).

- 3) Rregullore nr.22 datë 24.06.2011 “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike”
- 4) Vendim i AKEP 2557 date 10.04.2015 Për miratimin e dokumentit për Këshillim Publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.22 datë 24.06.2011 “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike”
- 5) Rregullore e Brendshme të AKEP miratuar me Vendimin nr. 2506 datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP

### K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (**Relacioni**),
2. Dokumenti “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike”(Përmbajtja)
3. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen dhe bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. Shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” janë të domosdoshme, për tu ardhur në ndihmë sipërmarrësve që veprojnë në fushën e ndërtimit të infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Dokumenti “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës duke patur parasysh dhe duke implementuar objektivat rregullatorë të AKEP.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Duke marrë në konsideratë përfundimet e këshillimit publik, rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në Ligjin nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të AKEP miratuar me Vendimin nr. 2506 datë 30.10.2014, Këshilli Drejtues i AKEP

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë përfundimin e këshillimit publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike”, dhe të publikojë mendimet dhe komentet e paleve të interesuara duke respektuar konfidencialitetin e informacionit sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren nr.22 datë 24.06.2011 “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e Internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

**1.Alban KARAPICI**

**2.Anila DENAJ**

**3.Ketrin TOPCIU**

**4.Klarina ALLUSHI**



**A K E P**

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

## Përfundimet e Këshillimit Publik

*“Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.22 datë 24.06.2011 “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”*

Bazuar në Ligjin nr. Nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2557 date 10.04.2015 për miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.22 datë 24.06.2011 “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërbane të komunikimeve elektronike”, AKEP kreu një Këshillim publik me palët e interesuara.

Në përfundim të afatit të Këshillimit Publik janë administruar komentet nga palët e interesuara si më poshtë:

- Shkresa nr.3937 datë 11.05.2015 opinionet e sipërmarrësit **A** lidhur me amendimin e Rregullores “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërbane të komunikimeve elektronike”
- Shkresa nr.prot 2847 datë 7.05.2015 (AKEP nr.prot.69/3 datë 11. 05.02015) e sipërmarrësit **B**, në kuadër të konsultimit publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.22 datë 24.06.2011 “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërbane të komunikimeve elektronike.

Më poshtë paraqiten komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP.

### **Sipërmarrësi A:**

Përsa i përket nenit **30/1**;

*“Në rastet e ndërtimit të godinave për qëllime biznesi ose të godinave të banimit, sipërmarrësit ndërtues detyrohen të ndërtojnë infrastrukturën për rrjetin e brëndshëm të komunikimeve elektronike, sipas lëgjislacionit në fuqi”.*

Në kushtet kur në godinat e reja është e pranishme infrastruktura e komunikimeve elektronike sërish ndeshen probleme të vazhdueshme më të drejtën e aksesimit në këtë infrastrukturë për shkak së në shumë raste sipërmarrësit/ndërtuesit e këtyre godinave nuk lejojnë sipërmarrësit të shtrijnë rrjetin e tyre por në mënyrë preferenciale u ofrohet aksesi në infrastrukturën e godinës vetëm një sipërmarrësi, prandaj sipërmarrësi A kërkon që në nenin 30/1 të shtohet fjalia duke e modifikuar si më poshtë.

**30/1).** “Në rastet e ndërtimit të godinave për qëllime biznesi ose të godinave të banimit, sipërmarrësit ndërtues detyrohen të ndërtojnë infrastrukturën, për rrjetin e brëndshëm të komunikimeve elektronike, sipas lëgjislacionit në fuqi, si dhe të sigurohet e drejta e barabartë dhe e paanshme për cdo operator të komunikimeve elektronike për përdorimin e kësaj infrastrukture”.

### **Oëndrimi i AKEP:**

AKEP merr në konsideratë sygjerimin sipërpërmendur, i cili do të pasqyrohet në Rregullore.

Në lidhje me pikat **j, k, l**, të nenit **35.4**, të këtij seksioni “**Masat e rekomanduara të projektimit**” **Sipërmarrësi A** shprehet si vijon:

**Për pikën j, të nenit 35.4** e cila përcakton se;

*“Duhet të meren masa për dhomat e pajisjeve të aksesit të jenë në vënde të përshtatshme të rrjetit kryesor të shpërndarjes”.*

Për shkak të nevojës së shtrirjes së rrjetit në godinat e reja të ndërtuara në interes të abonentit, si dhe për shkak të nevojës që këto dhoma të ndodhen në pozicione që sigurojnë edhe mosçënimin e saj nga ndërhyrjet, Sipërmarrësi A kërkon që;

Të modifiohet pika “**j**” e nenit **35.4**, ose të shtohet edhe një pikë tjetër vec asaj të propozuar në këtë dokument këshillimi publik, si më poshtë;

**j).** “Sipërmarrësit e ndërtimeve detyrohen që të sigurojnë në cdo godinë të re një dhomë të pajisjeve të aksesit, e cila të jetë në vënde të përshtatshme të rrjetit kryesor të shpërndarjes, sa më lehtësisht e aksesueshme fizikisht dhe e ruajtur nga ndërhyrjet.”

Ose shtohet;

**j).** “Sipërmarrësit e ndërtimeve detyrohen që të sigurojnë në cdo godinë të re një dhomë të pajisjeve të aksesit, sa më lehtësisht e aksesueshme fizikisht dhe e ruajtur nga ndërhyrjet

### **Oëndrimi i AKEP:**

AKEP merr në konsideratë sygjerimin sipërpërmendur dhe riformulon paragrafin si me poshte, i cili do të pasqyrohet në Rregullore

**j.)** “*Duhet të meren masa për dhomat e pajisjeve të aksesit të jenë në vënde të përshtatshme të rrjetit kryesor të shpërndarjes dhe te jene sa më lehtësisht e aksesueshme fizikisht e ruajtura nga ndërhyrjet*”.

**Përsa i përket pikës k);** Sipërmarrësi A gjen rastin këtu të shprehë se në shumicën e rasteve është praktikisht e pamundur që të ndërtohen dy linja aksesi të cilat drejtohen në krahë të ndryshëm të rrugës dhe si rrjedhojë kërkojmë që ky realitet të konsiderohet dhe në përkufizimin e kësaj pike ku sugjerojmë që kjo pikë të modifikohet si më poshtë;

**k).** *Nëse një shumëllojshmëri është e kërkuar, kur është e mundur të paktën dy kanale aksesi alternative duhet të sigurohen për të lidhur rrjetin kryesor të shpërndarjes në rrjetin kryesor të operatorit, por në cdo rast është e detyrueshme për të siguruar një kanal aksesi. Teorikisht ato*

*duhet të dërgohen përgjatë rrugëve të ndryshme të aksesit por në qoftë se vetëm një rrugë hyrje është në dispozicion, ato duhet të drejtohen një në cdo anë të rrugës kur është e mundur në të dy anët, nëse jo, atëherë duhet të garantohet të paktën në njërin anë.*

Ndërsa lidhur me **shkronjën I**); Sipërmarrësi A shpreh mendimin se nëse AKEP do të kërkonte nga institucionet vendore/lokale të vëndit planet periodike të zhvillimit kjo gjë do tu vinte në ndihmë operatorëve në mënyrë që të bëhet i mundur parashikimi për shtrirjen dhe ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike në zonat përkatëse.

### **Qëndrimi i AKEP:**

Në lidhje me sugjerimet për gërmen k), AKEP merr në konsideratë sugjerimet sipërcituar të cilat do të pasqyrohen në rregullore.

Në lidhje me sugjerimin e shkronjës I), AKEP sqaron se në bazë të ligjit 9918, i ndryshuar, nuk ka kompetenca mbi institucionet vendore. AKEP gjithmonë ka bashkëpunuar me njesitë vendore në rastet kur kanë pasur plane të zhvillimit të cilat i ka administruar në sitimin ATLAS . Gjithashtu sygjerohet një bashkëpunim më i ngushtë midis sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe njesive vendore.

Në lidhje me “**Aneksin I**” Sipërmarrësi A citon se bazuar në eksperiencën nuk dinë të ketë standartizime/rekomandime ndërkombëtare të shtyllave metalike apo ndërtime rrjeti kabllorë me shtylla metalike. Për më tepër, të paktën deri tani, nuk janë njohur me asnjë lloj studimi apo çertifikimi mbi kushtet teknike të mënyrës së ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve me shtylla metalike ku të jenë të parashikuara:

- mbrojtjet e rrjetit,
  - siguria teknike gjatë të punuarit qoftë në ndërtim, instalim të rrjetit me këto shtylla metalike, apo mirëmbajtje të tij,
- si dhe
- manualët e punës për teknikun, qoftë për të kryer shërbimet e punimit në shtyllë apo për sigurinë e jetës.

Prandaj, duke patur parasysh sa më lart, Sipërmarrësi A nuk jep dakortësinë për përdorimin e shtyllave metalike në ndërtimin e rrjeteve. Megjithatë, në qoftë se AKEP gjykon që të përfshijë në standarte/specifikime edhe përdorimin e këtyre shtyllave, duhet të konsiderojë patjetër të gjitha shqetësimet më sipër.

### **Qëndrimi i AKEP**

AKEP nisur nga situata kaotike e rrjeteve të komunikimeve elektronike nxori për konsultim publik Aneks 1 bashkëlidhur pas Seksionit V , me qëllim përmirësimin e këtyre rrjeteve.

Duke qenë se AKEP bazohet vetëm në standartet e rekomanduara nga ITU, vlerëson komentet dhe sygjerimet e sipërmarrësve që operojnë në fushën e komunikimeve elektronike, në përfundim AKEP vendos që Aneks 1 bashkëlidhur të mos jetë pjesë e kësaj Rregulloreje.

Sipërmarresi A thekson se, në çdo rast ashtu sikurse parashikohet edhe në rregulloren ekzistuese **seksioni IV, neni 31.3**, në standartet e ndërtimit të rrjetit të komunikimeve elektronike, parësore **duhet të jetë përdorimi i shtyllave të drurit, për të cilat ekzistojnë të gjitha standartet dhe katalogjet përkatëse.**

**Sipërmarresi A** vëren se **Aneksi I**, “*Profillet e standarteve të rekomanduara*” e cilësuar në dokumentin për këshillim publik gjëndet pas seksionit **V**, “*Instalimi i infrastrukturës së rrjeteve të komunikimit elektronik në godina dhe blloqet e ndërtuara për banim*” por pa u cilësuar si **Aneks I** me titullin përkatës por titullohet “*Specifikime Teknike*”.

### **Qëndrimi i AKEP**

**AKEP**, vlerëson sugjerimin e sipërmarrësit A, dhe ka vendosur që Aneks 1 bashkëlidhur, pas seksionit V të mos jetë pjesë e kësaj Rregulloreje.

### ***Sipërmarresi B:***

Ne rregullore (Aneksi 1) trajtohet gjërësisht infrastruktura ajrore, infrastrukture e cila nuk është pjesë e standarteve të BE-së. Sipërmarresi B mbështet vetëm infrastrukturën nëntokësore ku synon të zgjerojë aktivitetin e tij në të ardhmen në drejtim të përmirësimit të teknologjisë zhvillimit të shërbimeve rehabilitimin e rrjetit sipas standarteve dhe rregullave të cilat ofrojnë kushte teknike të sigurta harmonizimin e infrastrukturës me mjedisin shmangien e përsëritjeve për përmirësime të rrjetit, respektimin e ambienteve të përbashkëta infrastrukturore etj. Avantazhe që ofron kjo infrastrukturë.

Referuar po Aneksit 1, trajtohet vetëm rrjeti Coaxial, Pon/Ftth duke përjashtuar rrjetin ADSL2+, Fibër Optike (FTTH Gepon / EPON), ndaj kërkohet të përfshihen llojet e tjera e infrastrukturës së telekomunikacionit.

Referuar specifikimeve teknike. Sipërmarresi B sugjeron si më poshtë:

Referuar skicës së vendosjes së mikrotubave në bankinë me asfalt tregohet nëpërmjet skicës që kjo mund të aplikohet vetëm në shtrimin e linjave interurbane, duke e lënë jashtë infrastrukturën urbane. Arsyeja është se tubacionet shtrihen në trotuar, hapjet e kanaleve, tubacionet kanë përmasa të tjera, ndaj ne propozojmë zgjidhjet teknike me ndërtimin e infrastrukturës urbane.



Referuar tipit të pusëtës për F.0(0.8x0.6). prerja a-a. propozohen përfshirja e përmasave të tjera të pusëtave, në varësi të madhësisë së trotuarit dhe mjeteve të renda që kalojnë në të.

### **Qëndrimi i AKEP:**

AKEP vlerëson sugjerimin sipercituar dhe sqaron se standartet e kerkuara nga sipermarresi B janë të përfshira në Rregullore.

Referuar shtrimit të kabllave shtyllë-pallat 5-6 katësh (rrjet coaxial), për kalimin e kabllave nga shtylla në pallate, Sipermarresi B shprehet kategorikisht kundra vendosjes së këtij standarti në ndërtimet e rrjeteve urbane, për arsye si më poshtë:

- Thyerja e standardeve të sigurisë teknike, duke sjellë burim për aksidente;
- Dëmtimet e fasadave nga fluksi kabllave dhe vendosja e ganxhave;
- Lagështia që shkaktohet brenda apartamenteve të banoreve, si pasojë e vrimave të hapura;
- Rastet e dëmtimit të shtyllave që mund të shkaktojnë deri në rrëzimin e tullave, duke sjellë pasojë aksidentale si për banorët dhe kalimtarët rastësor.

Sipermarresi B propozon që për të gjitha kabllimet në zona urbane, infrastruktura të jetë nëntokësore, pa prekur fasadat e pallateve, duke u futur në pusin teknik të pallatit. Në mungesë të pusit, kalimi me tub të bëhet deri tek muri i jashtëm i pallatit dhe në asnjë rast ajror.

Referuar shtrirjes së kabllave shtyllë-shtyllë. Sipërmarrësi B shprehet se nuk është dakord për vendosjen e shiritit metalik në lidhje me fiksimin e kabllave, kjo për arsye sepse nuk garanton sigurinë e nevojshme dhe është lehtësisht i cënueshëm, bëhet objekt i grabitjeve. Në propozojmë që raizeri të fiksohet me fashetat shoqëruese që ka vetë raizeri.

Referuar, shtyllë hekuri 6 m: profil 120 x 120 spesor 4 mm. Për këtë pikë Sipërmarrësi B propozon përfshirjen e formave dhe madhësit të tjera të shtyllave, shtyllë hekuri 6m; profil 100x 100 spesor 2.7-3 mm.

Referuar shtrirjes së kabllave shtyllë-pallat puse teknike (rrjet – pon/ftth) Për kalimin e kabllave nga shtylla në pallat, Sipërmarrësi B shprehet kundra aplikimit të këtij standarti dhe propozon që në infrastrukturën e pallateve të vendoset një tubacion i veçantë, i brinjëzuar ϕ 32 ku shtrirja të bëhet nga pusi teknik i pallatit deri tek apartamenti me qëllim shtrimin e kabllave fibër optike, bakër, coaxial.

Në lidhje me Aneksat Teknike të paraqitura me skica bashkëlidhur nga sipërmarrësi Sipërmarrësi B,

### **Qëndrimi i AKEP sqaron:**

AKEP nisur nga situata kaotike e rrjeteve të komunikimeve elektronike nxori për konsultim publik Seksioni V , (Aneks bashkëlidhur) me qëllim përmirësimin e këtyre rrjeteve.

AKEP vlerëson komentet dhe sugjerimet e sipërmarrësit Sipërmarrësi B në këtë drejtim.

AKEP ka vendosur që Aneks 1 bashkëlidhur, pas seksionit V të mos jetë pjesë e kësaj Rregulloreje.

Me qëllim permiresimin e infrastruktures se rrjeteve te komunikimeve elektronike duke qene sa me perditesuar edhe me standartet e perdorura, në **Nenin 1, shtohet pika 1.10** si më poshtë.

**1.10** Të gjitha standartet e tjera të përdorur, të cilët nuk janë të përfshira në këtë rregullore, duhet të jenë konform standarteve të ITU në rekomandimet e **Series L: “Construction, Installation and Protection of Cables and Other Elements of Outside Plant”**